

Ndihmësmagjistrat i komanduar pranë Gjykatës së Lartë

Engjëllushe TAHIRI u lind më 17 shtator 1982. Në vitin 2005 kreu studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ka ushtruar profesionin si jurist në Zyrën Juridike të N/Prefekturës Kavajë, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe pedagog universitar.

Në vitin 2011 fillon marrëdhënien si lektore e të drejtës civile pranë Universitetit jopublik *“Akademia Profesionale e Biznesit”*. Në vitin 2016 Pedagoge e jashtme pranë Universitetit publik *“Aleksandër Moisiu”* Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike viti i parë, për lëndën *“E drejta Kushtetuese”*, ndërsa në vitin 2017 Pedagoge e jashtme pranë të njëjtit fakultet për lëndën *“Të drejtat e njeriut”*.

Është autore e shkrimeve në Revistën Juridike Shkencore, *“Jeta Juridike”* nr. 4, dhjetor 2008, botim i Shkollës së Magjistraturës, shkrimi me temë *“Forma e kontratës së shitjes së pasurive të paluajtshme dhe rëndësia e saj”*, si dhe botimit me titull *“Rekomandime dhe opinione rreth projektit ‘Për një drejtësi pa vonesa’*, maj 2014 mundësuar nga USAID Albania.

Zj.Tahiri njeh shumë mirë tre gjuhë të huaja, italisht, anglisht dhe frëngjisht, për të cilat disponon edhe dëshmitë përkatëse.

Në muajin shtator të vitit 2006 ka nisur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës Tiranë në profilin gjyqtar. Nga muaji janar i vitit 2009 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në muajin qershor 2010 deri në tetor 2020 ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në datën 20.10.2020 me vendimin nr. 432, datë 14.10.2020 është komanduar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.